



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.1.2023

Nr: 17

Ora: 11:00

V E N D I M

P Ë R

MIRATIMIN E ELEMENTEVE DHE PËRMBAJTJES SË ZARFEVE TË SIGURISË QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJE

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 99, pika 1 shkronjat “d”, “dh”, “e”, nenit 118, pika 5, nenit 119, pika 3, dhe neni 120, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Zarfet e sigurisë që përdoren nga Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe grupet e numërimit duhet të përmbajnë elementet e mëposhtëm:
 - a) Logon (emblemën) më të fundit me ngjyrë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ),
 - b) Llojin e zgjedhjeve,
 - c) Datën e zgjedhjeve,
 - ç) Numrin e KZAZ-së dhe hapësirën përkatëse për plotësimin e tij,
 - d) Zonën Zgjedhore (për zgjedhjet në Kuvend Qarku/ për zgjedhjet vendore Bashkia) dhe hapësirën përkatëse për plotësimin e tij,
 - dh) Emërtimin e qëllimit të përdorimit të zarfit si vijon:
 - i. Për zgjedhjet vendore:
 1. Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme për kandidatët për kryetar bashkie,
 2. Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme për kandidatët për këshillin e bashkisë,
 3. Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara për kandidatët për kryetar bashkie,
 4. Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara për kandidatët për këshillin e bashkisë,

Data: 25.1.2023 Nr: 17
Ora: 11:00



“Për miratimin e elementeve dhe përmbajtjes së zarfeve të sigurisë që do të përdoren në zgjedhje”

5. Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për këshillin e bashkisë për subjektin zgjedhor,
 6. Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për kandidatin për kryetar bashkie,
 7. Zarfi i votave për këshillin e bashkisë të hedhura gabim në kutinë e kryetarit,
 8. Zarfi i votave për kryetarin të hedhura gabim në kutinë e këshillit të bashkisë.
- ii. Për zgjedhjet për Kuvend:
1. Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme,
 2. Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara për kandidatët,
 3. Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara për subjektet zgjedhore,
 4. Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për subjektin zgjedhor,
 5. Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për kandidatin për deputet.
- e) Hapësirën për nënshkrimin (emër, mbiemër, firmë) të Sekretarit,
- ë) Hapësirën për nënshkrimin (emër mbiemër firme) të Numëruesit të parë.
2. Zarfet e sigurisë që përdoren nga Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV) duhet të përmbajnë elementet e mëposhtëm:
- a) Logon (emblemën) më të fundit me ngjyrë të KQZ-së,
 - b) Llojin e zgjedhjeve,
 - c) Datën e zgjedhjeve,
 - ç) Numrin e KZAZ-së,
 - d) Numrin e QV-së,
 - dh) Emërtimin e qëllimit të përdorimit të zarfit, si vijon:
 - i. Zarfi i fletëve të votimit të dëmtuara,
 - ii. Zarfi i fletëve të votimit të papërdorura,
 - iii. Zarfi i procesverbalit të vulosjes së kutisë/ kutive të votimit,
 - e) Hapësirën për nënshkrimin (emër, mbiemër, firmë) të Kryetarit të Qendrës së Votimit,
 - ë) Hapësirën për nënshkrimin (emër, mbiemër, firmë) të Sekretarit të QV-së.
3. Zarfet e sigurisë duhet të kenë ngjyra të ndryshme sipas qëllimit për të cilin përdoren dhe të mbajnë kodin përkatës në shifra dhe në barcode.
4. Përcaktimi i sasive, dizenjimit, specifikimeve teknike të materialeve, si dhe i kriterëve e specifikimeve teknike të tjera veçmas atyre që përmban ky vendim bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të bëjë kodifikimin e materialeve dhe për çdo proces zgjedhor dhe të miratojë dhe publikojë modelet specifike për përdorim të standardizuar nga administrata zgjedhore.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI